



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	27-09-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	5705/2022		115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.677/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.677/2022 të datës 01.08.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson me adresë banimi

Komunën e Prishtinës, në çështjen juridike "transferim" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.677/2022 e datës 01.08.2022, e parashtruar nga ankuesi**

**II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.1129/2022 i datës 19.07.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe lënda kthehet në rivendosje tek organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.**

**III. Detyrohet Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që brenda afatit prej 15 ditësh, të ndërmar veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit.**

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.**



## A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme sipas Akt emërimit Nr.779 të datës 02.12.2013 në pozitën “Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion”. Me datën 19.07.2022, zëvendës Drejtoresha e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka nxjerrë Vendimin Nr.1129/2022 sipas të cilit ankuesin për shkak të konfliktit të interesit e ka transferuar përhershëm nga pozita Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion në pozitën Drejtor i Departamentit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në kuadër të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave/MPB, nga data 19.07.2022, me arsyetimin se ndaj të njëjtit Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur Aktakuzën.PS.nr.33/2019 të datës 24.02.2021 gjë që e njëjta është konfirmuar edhe nga gjykata themelore dhe ajo e apelit të Kosovës.

I pakënaqur me Vendimin e zëvendës Drejtoreshës së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 01.08.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4435/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve ligjore, materiale e procedurale.

Me datën 12.09.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.94/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:4435/2022 të datës 01.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 12.11.2021 nga përfaqësuesi i ankuesit; Ndryshimin e akt emërimit të ankuesit me numër Nr.779 të datës 02.12.2013; Vendim Nr.042 të datës 19.01.2022 lidhur me transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil-ankuesit; Njoftimin me numër 390/2022 të datës 28.01.2022 lidhur me mos zbatimin e vendimit të Këshillit nga përfaqësuesi i ankuesit; Vendimin Nr.1129 të datës 19.07.2022 lidhur me transferimin e përhershëm të nëpunësit civil-ankuesit; Certifikatën e ankuesit me numër Nr.8302/354 të datës 10.11.2006 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i departamentit të zjarrfikjes dhe shpëtimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 17.08.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Përshkrimin e detyrave të punës të punës për pozitën Drejtor i departamentit për shtetësi, azil dhe migracion; Kërkesën e datës 13.01.2022 përmes e-mailit zyrtar; Kërkesën e datës 12.01.2022 përmes e-mailit zyrtar; Kërkesën e ankuesit të datës 30.03.2020 me numër Nr.23 lidhur me transferim; Akt emërimit e ankuesit me numër AE.Nr.109/2022 të datës 04.08.2022; Kërkesën



e datës 12.08.2022 përmes e-mailit zyrtar; Kërkesën e datës 18.07.2022 përmes e-mailit zyrtar dhe Vendimin VK.nr.94/2022 te datës 12.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar janë përmbushur kushtet ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në rivendosje, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka shqyrtuar Vendimin Nr.1129/2022 të datës 19.07.2022 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe si rrjedhojë ka gjetur se vendimi për transferimin e përhershëm të ankuesit nga pozita si Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion ne kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.6, ku përcaktohet se: 1. *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.3 shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.* Vendimi në fjalë, në arsyetimin e tij përmban vetëm bazën ligjore mbi të cilën është nxjerr vendimi dhe një përshkrim të gjendjes faktike, citoj: *“Duke u bazuar në faktin qe ushtrimi i detyrës se Drejtorit te Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migracion nga do te paraqet konflikt te vazhdueshëm te interesit, do te dëmtonte imazhin e Ministrisë dhe do te ndikonte ne mos besueshmërinë ne opinionin publik vendor dhe ndërkombëtar....”* si dhe citoj *“Duke u bazuar ne faktin qe nga organet kompetente është konfirmuar se ndaj lidhur me ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësiive te detyrës se Drejtorit te Departamentit për Shtetësi dhe Azil është ngritur Aktakuza PS.nr.33/2019 e datës 224.02.2021 nga Prokuroria Speciale e Kosovës dhe qe e njëjta është konfirmuar nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit dhe qe edhe pas përfundimit te afatit te transferimit te përkohshëm, kemi te bëjmë me te njëjtat rrethana për te cilat ka kërkuar transferim për shmangie te konfliktit te interesit, me qellim te ruajtjes se imazhit te institucionit si dhe shmangies se konfliktit te mundshëm te interesit....’* mirëpo i njëjti vendim nuk përmban faktet vendimtare si: Përgatitjen profesionale të ankuesit dhe kriteret të cilat kërkohen për pozitën përkatëse të transferimit, si dhe përvojën e punës së ankuesit dhe arsyeën pse kjo përvojë është adekuate në rastin konkret. Rrjedhimisht, arsyetimi i vendimit nuk përmban përshkrimin rreth përshtatshmërisë së ankuesit për pozitën përkatëse e cila do t’i siguronte palës mundësinë që ta kuptonte aktin administrativ. Po ashtu, vendimi i kontestuar nuk përmban një shpjegim të gjendjes faktike, nëse në kohën e transferimit të përhershëm të ankuesit ka qenë vetëm kjo pozitë e lirë, apo ka pasur më shumë pozita të lira por emërimi është bërë sipas diskrecionit të Drejtorit të DMZP-së, pa e marrë për bazë kualifikimin e përvojës profesionale të cilën e posedon ankuesi dhe përvojën profesionale e cila kërkohet sipas pozitës në të cilën është transferuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, ka analizuar po ashtu edhe dispozitat e nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik ,konkretisht detyrat dhe kompetencat e kësaj agjencie ku janë të përfshira



veprimet ligjore të cilat i ndërmerr kjo agjenci në rastet e konfliktit të interesit të personave si dhe nenin 22 të këtij ligji ku theksohet procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit dhe ndërlidhur me rastin e ankuesit ka konstatuar se meqenëse vendimi për transferim të përhershëm është i bazuar mbi bazën e konfliktit të interesit, për shkak se ankuesi ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësisive nga pozita si Drejtor i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion në Ministrinë e Punëve të Brendshme nuk mund ta ushtroj me arsyetimin se ndaj te njëjtit është ngritur Aktakuza PS.nr.33/2019 e datës 24.02.2021 nga Prokuroria Speciale e Kosovës, atëherë organi i punësimit është dashur që fillimisht të ndërmerr veprime juridike në atë drejtim, që të parashtrij kërkesë apo të marrë mendim për rastin e ankuesit tek Agjencia Kundër Korrupsionit dhe pastaj të veproj konform udhëzimeve të dhëna nga Agjencia dhe legjislacionit në fuqi.

Kolegji bazuar në konstatimet e mësipërme, vlerëson se të metat e tilla të aktit administrativ e bëjnë të paligjshëm Vendimin Nr.1129/02 të datës 19.07.2022 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si rezultat i kësaj nuk ka qenë i mundur trajtimi i ligjshmërisë së pretendimeve ankimore dhe vendosjes në mënyrë meritore lidhur me ankesën, kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafit 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që lënda e ankuesit të kthehet në rivendosje tek organi i njëjtë, gjegjësisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në procedurë të rivendosjes, duhet t'i marrë parasysh pikëpamjet juridike të këtij vendimi dhe t'i eliminoj të metat e konstatuara të aktit administrativ.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.677/2022, datë 27/09/2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit,
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

